



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, 03 mars 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.
Mungoi: Slllobodan Petroviq

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS): Fadil Rracaj dhe Gjylnaze Novobërdaliu-Gola.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati,

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri,

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti dhe Fitore Zeneli.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës para miratimit në parim Nr. L-136;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit punues lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës para miratimit në parim

Sadik Idriz – Tha se në Kuvend është proceduar Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Meqenëse nuk e kemi Ligjin bazik të punës, si komision kemi pasur dilema nëse ky ligj duhet të miratohet në parim ose jo. Për të marrë informata lidhur me këtë, komisioni ka ftuar përfaqësues nga zyra ligjore e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për t'u informuar se si e kanë paraparë ata që ky ligj të jetë i zbatueshëm pa Ligjin bazik të punës. E hapi diskutimin.

Fadil Rracaj – përfaqësues nga MPMS– Tha se Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, është hartuar në harmoni me të gjitha procedurat që janë të paraparë me rregulloren e Qeverisë. Ky Projektligj bazueshmërinë ligjore e ka në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 41 të Ligjit për të huajt. Qëllimi i Projektligjit është krijimi i bazës ligjore për punësimin e shtetasve të huaj si dhe krijimi i dispozitave ligjore nga marrëdhënia e punës dhe punësimit në përputhje me ligjin për të huajt, me konventat ndërkombëtare dhe me marrëveshjet ndërshtetërore që do të bëjë Kosova në të ardhmen. Nevoja për këtë ligj është shumë e madhe, duke pasur parasysh faktin se një numër shumë i madh i të huajve, punojnë në Kosovë pa kurrfarë kushtesh dhe kriteresh. Lidhur me dilemën nëse ky Projektligj duhet të procedohet pa u proceduar Ligji i punës ose jo, qëndrimi i MPMS është se ky Projektligj duhet të shkoi në miratim me mundësi që në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të thuhet që: *“ligji do të jetë i zbatueshëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit të punës”*.

Mimoza Ahmetaj – Tha, sipas titullit ky Projektligj rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat e punësimit të shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi. Në Kuvend ka kaluar Ligji që e rregullon çështjen e shtetësisë dhe ai ligj akoma nuk është në fuqi. Si e ka menduar MPMS-ja ta rregulloi çështjen e personave që kanë të drejtë në shtetësinë e Kosovës, e nuk e kanë këtë shtetësi.

Teuta Hadri – Pyeti: A është paraparë kostoja financiare për këtë Projektligj. Si do të jenë qytetarët e huaj përgjegjës ndaj ligjit, kur ne nuk e kemi ligj bazik.

Gjylnaze Sylja – Tha, ky Ligj nuk ka fuqi juridike derisa të aprovohet ligji bazik-ligji për punën, prandaj nuk duhet të jetë në agjendë. Prioritet është Ligji bazë i punës. Ky Projektligj nuk po e arrin qëllimin e vet, domethënë nuk e zvogëlon ekonominë joformale dhe nuk vënë në kontroll këtë sektor, sepse nuk është i plotë dhe nuk e ka fuqinë ligjore pa Ligjin bazë të punës. Qëllimi është që ky ligj të zbatohet. Kjo sferë duhet të rregullohet, por duhet përcaktuar prioritetet. A kemi më shumë punëtor të huaj, apo punëtorë vendor? Nëse kemi më shumë punëtorë vendor, atëherë prioritet është rregullimi i punësimit të tyre. A ka ndonjë dispozitë në Rregulloren e punës për themelimin e marrëdhënies së punës për punëtorët e huaj apo jo?

Gjylnaze Novobërdaliu-Gola – përfaqësuese nga MPMS –Lidhur me punësimin e shtetasve të huaj në Kosovë tha se ekziston një anarki. Ata vijnë në Kosovë, punojnë, punësojnë dhe përfitojnë pa kurrfarë baze ligjore. Ky ligj mund të procedohet edhe pa Ligjin e Punës, sepse ekziston Rregullorja për themelimin e marrëdhënies së punës, por kjo rregullore nuk ka asnjë dispozitë që u referohet të huajve. Me këtë Projektligj rregullohen vetëm lejet e punës.

Fadil Rracaj – Tha se Ky Projektligj ka të bëjë me dy kategori: me shtetasit e huaj dhe me personat pa shtetësi (apatrid). Sa i përket kostos financiare ky Projektligj është prej ligjeve të rralla të MPMS-së, që nuk ka implikime negative për buxhetin e Kosovës. Qëllimi i aprovimit të këtij ligji para ligjit të punës është që të ecim në hap me kohën.

Armend Zemaj – Tha se ka dilema nëse duhet të miratohet në parim ose jo një ligj i cili do të jetë i zbatueshëm vetëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit të punës.

Rita Hajzeraj – Tha, nëse disa nga dispozitat e këtij Projektligji mund të implementohen edhe pa Ligjin e punës, e mbështet procedimin e mëtutjeshëm të tij. Por, nëse ky ligj në tërësinë e tij nuk mund të implementohet pa Ligjin e punës, atëherë duhet të presim.

Nurishahe Hulaj – Tha se në Kosovë ka shumë të huaj pa kurrfarë evidence dhe pa kurrfarë kriteri dhe kjo mund të jetë arsye e fortë për të proceduar këtë Projektligj. Për nga përmbajtja ky Projektligj rregullon vetëm lejet për punë. Ky Projektligj thirret në rezoluta, në rekomandime të BE-së, por të cilat nuk janë obligative. Nëse e miratojmë këtë Projektligj, ne do të kemi kundërshtime edhe nga të punësuarit tanë të cilët nuk kanë kritere dhe të drejta të plota të punës të mbrojtura me ligj.

Flora Brovina – Tha se ne nuk po i mbrojmë punëtorët tanë dhe po bëjmë ligje për ata që do të vijnë për të punuar në Kosovë. Është absurde të bëjmë ligj për të huajt e ne nuk e dimë numrin e të huajve në Kosovë. Nuk mund të bëjmë ligj vetëm për faktin se ka shumë njerëz dhe së dyti të bëhet një ligj i cili nuk e ka ligjin bazik. Shumë ligje në mandatin e kaluar i janë kthyer MPMS-së, sepse janë të lidhura me Ligjin e punës dhe kjo ka qenë një formë e presionit që, Ligji i punës të procedohet. MPMS-ja ka proceduar një ligj i cili fare nuk i mbron qytetarët tanë, por është ligj për integritet evropian. Ne jemi shumë larg integriteteve evropiane. Nga kjo po shohim se ne së pari duam të realizojmë integritet evropian, e pastaj të drejtat e qytetarëve tanë. Pyetje për përfaqësuesit e MPMS-së: Saktë, sa njerëz i mbron ky Projektligj? Nëse ne e miratojmë këtë ligj, atëherë ligji bazik duhet të përshtatet këtij ligj, apo jo?

Qamile Morina – Tha se në këtë fazë të ndërtimit të infrastrukturës ligjore, gjithmonë duhet të kemi prioritet. Ligji bazik i punës duhet të jetë prioritet. Nëse vendosim ta procedojmë këtë Projektligj, me arsyen se disa nga dispozitat e tij mund të zbatohen edhe para miratimit të Ligjit të punës, kjo mund të sjellë subjektivizëm dhe interpretim jo të mirë gjatë implementimit të këtij ligji. Kështu nuk do të arrihet qëllimi final i ligjit. Ky Projektligj ashtu kështu nuk do të implementohet pa Ligjin e punës, atëherë të japim prioritet ligjit bazik.

Mimoza Ahmetaj – Pyeti: Në çfarë faze ndodhet përgatitja e Ligjit të punës në raport me këtë ligj, në mënyrë që ne të kemi një orientim kohor të përafërt.

Bujar Bukoshi – Tha se Kosova është një shtet i ri me shumë probleme dhe nuk ka mbaruar punën me nxjerrjen e ligjeve. Ne jemi duke parë se si po gufon biznesi i qytetarëve kinez të cilët bëjnë një qarkullim të mirë të parave e që nuk është për t'u nënçmuar. Angazhimi ynë duhet të jetë që të fillojmë me ligje bazë, por meqenëse nuk po mundemi atëherë në dispozitat përfundimtare duhet të përfshijmë dispozitën me të cilën saktësojmë se ky ligj hyn në fuqi pasi që të hyj në fuqi Ligji të punës. Ne duhet të shikojmë edhe përputhshmërinë me Acquis Communautaire, sepse kjo është shumë e rëndësishme.

Fadil Rracaj – përfaqësues nga MPMS-ja - Tha, dokumente bazë për hartimin e këtij Projektligji janë marrë Kushtetuta, Ligji për të huajt dhe Ligji i punës. Përmes këtij ligj rregullohet dhënia e lejeve për punë, regjistrimi i bizneseve dhe vetëpunësimi i të huajve, marrja e punëve nga kompanitë e ndryshme. Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare ne mund të themi që ky ligj ose mund të

zbatohet pjesërisht ose të mos zbatohet fare deri në nxjerrjen e Ligjit për punën. Ne nuk e dimë numrin e të huajve që punojnë në Kosovë, por është një invazion i madh.

Gjynaze Novobërdaliu -Gola-përfaqësuese nga MPMS-ja- Tha se Qeveria në fund vit përcakton kuotat se sa leje të punës për të huajt do të lëshoi. Dhe me këtë qeveria e mbron qytetarin e vet. Përveç nenit që i referohet kontratës së punës, i gjithë ligji ka të bëjë me rregullimin e lejeve për punë. Sa i përket Ligjit të Punës grupi ndërministror ka mbaruar me punë, tani do të filloi grupi qeveritar i cili do të përfundoi punën deri në fund të muajit mars.

Sadik Idriz – Tha se Projektligji mund të procedohet tutje sepse vetëm dy dispozita i referohen ligjit të punës ndërsa pjesa tjetër e këtij projektligji mund të zbatohet. Ky Projektligj vetëm në një pikë mund të jetë në kolizion me ligjin për punën.

Gjynaze Syla – Tha, nuk ekziston një koncept i politikave të punësimit. Përfaqësuesit e MPMS thanë se ky ligj rregullon vetëm lejen për punë dhe nëse është kjo atëherë ky Projektligj nuk rregullon punësimin. Ky Projektligj duhet të quhet Projektligji për dhënien e lejeve për punë për shtetasit e huaj. Pse duhet ta komplikojmë duke shkuar me dispozita kalimtare. Projektligji nuk është prioritet dhe meqenëse nuk e arrin qëllimin, atëherë nuk duhet të kalojë si i tillë.

Mimoza Ahmetaj – Tha se nuk shoh urgjencë për të cilën ky komision duhet të votoi sot për këtë Projektligj. Propozoi që ky Projektligj të jetë për shqyrtim edhe në mbledhjen e radhës. Në Kosovë ka shtetas të huaj që kanë të drejtën për shtetësi, por Ligji për shtetësinë akoma nuk ka hy në fuqi. Përfaqësuesit e MPMS thanë se në këtë Projektligj përfshihet edhe ajo kategori.

Teuta Hadri – Tha se e vlerëson shumë faktin që komisioni ka ftuar në takim përfaqësuesit e MPMS, për diskutimin e Projektligjit para miratimit në parim. Edhe pse në fillim ka pas dilema rreth procedimit ose jo të këtij Projektligji, megjithatë pajtohet që ky ligj të procedohet sepse shtetasit e huaj e kanë vërsuar Kosovën. Ne si komision pastaj bëjmë monitorimin e këtij ligji dhe mund të bëjmë ndryshime.

Flora Brovina – Tha se lejet për punë nuk i lëshon MPMS-ja, por Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ata kanë rregullativat e veta dhe me siguri kanë kontrollin se kujt i lejojnë punën dhe kujt jo. Punësimi joformal ndoshta luftohet pak më ndryshe. Ministria e Tregtisë duhet të ketë inspektoratin për të vërtetuar nëse këta punëtorë punojnë me leje ose jo. Më këtë Projektligj të huajt vetëm mund të përfitojnë sepse Ligji për sigurime shëndetësore nuk ekziston dhe këta të huaj mund të shërohen pa pagesë sikurse shtetasit e Kosovës. S'ka nevojë për ngutje, por të konsultohemi edhe me Ministrinë e Tregtisë.

Pas diskutimeve të deputetëve komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës shtyhet për diskutim në mbledhjen e radhës të komisionit, para miratimit në parim.

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit punues lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi

Sadik Idriz- Tha se, të gjithë anëtarët e komisionit kanë pranuar raportin përfundimtar me rekomandime, lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, të përgatitur nga grupi punues i këtij Komisioni. Hap diskutimin

Qamile Morina – raportuese- Tha se grupi punues është takuar në përbërje të plotë dhe ka përgatitur raportin përfundimtar me rekomandime. Anëtarët e komisionit mund të bëjnë propozime dhe vërejtje.

Nurishahe Hulaj – Tha se raporti është shumë i mirë. Propozoi që rekomandim të futet edhe krijimi i mekanizmave për partneritet publiko-privat. Ministria e Shëndetësisë së pari duhet të hartoi normativat dhe standardet në sistemin shëndetësor, sepse në bazë të këtyre normativave dhe standardeve caktohet minutazha e çdo personeli shëndetësorë e në bazë të kësaj caktohet koha sa ka për të punuar secili personel. Së pari duhet të bëhen standardet dhe normativat e pastaj të bëhet çmimorja.

Qamile Morina – Lidhur me rekomandimin e deputetes Nurishahe Hulaj, tha se ligji nuk e parasheh këtë. Meqenëse raporti ka të bëjë me monitorim të ligjit, atëherë grupi punues është bazuar vetëm në të gjeturat që janë paraparë me ligj.

Gjylnaze Syla – Tha se falënderon grupin punues, sidomos raportuesen e cila ka punuar me shumë përkushtim, stafin mbështetës, si dhe NDI-në, për mbështetjen e dhënë grupit punues për punën e bërë. Raporti është qëndrim unanim i grupit punues, duke përfshirë këtu rekomandimet, konkluzionet dhe problemet e identifikuar. Propozoi që në pjesën e raportit ku është paraparë *“mirënjohja për ata që kanë bashkëpunuar me komisionin”* të jetë *“falënderim”*.

Teuta Hadri – Tha se raporti është shumë i mirë, por shumë rekomandime të përfshira në këtë raport janë rekomandime të cilat i ka paraparë Ministria e Shëndetësisë për punën në institucione private shëndetësore. Si p.sh: çmimorja - asnjë institucion privat shëndetësor, nuk mund të marr leje për punë nëse nuk përmbush këtë kriter.

Qamile Morina – raportuese – Tha se Ministria e Shëndetësisë e ka Ligjin për veprimtari private në shëndetësi dhe nëse ai ligj do të zbatohet, komisioni nuk do të kishte nevojë të bëjë këto rekomandime.

Këshilli i Përgjithshëm Profesional duhet të bëjë çmimoren e harmonizuar. Ne nuk mund të mësojmë dikë se si duhet ta bëjë këtë, por ne i referohemi nenit të cilin ata janë të obliguar ta zbatojnë. Pajtohemi me propozimin që duhet të jenë normativat dhe standardet, por ajo është pjesë që i takon Këshillit Profesional.

Sadik Idriz – Tha se raportit, pas miratimit në komision do të bashkohet edhe një faqe përcjellëse. Propozoi që rekomandimet e propozuara nga grupi punues duhet të renditen me numër.

Pas diskutimeve të deputetëve komisioni nxori këtë

Përfundim

- Miratohet raporti me rekomandime lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për veprimtari private në shëndetësi

5. Të ndryshme

Sadik Idriz – Tha se ka qenë duke planifikuar një vizitë të komisionit në FSSHK, por meqenëse greva e punëtorëve shëndetësorë ka përfunduar, atëherë edhe vizita nuk do të realizohet. Ne mund të ftojme në takim përfaqësuesit e FSSHK-së . Ne do të ftojme në takim ministrin e Ministrisë së

Shëndetësisë dhe ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Propozoi që të dy ministrat të ftohen në të njëjtën ditë.

Mimoza Ahmetaj – Propozoi që ministrat të mos ftohen në të njëjtën ditë, sepse ne duam të diskutojmë dhe nuk mund të marrim informatat që neve na interesojnë për një kohë kaq të shkurtër.

Gjynaze Syla – Tha se e përkrah propozimin që të dy ministrat të mos ftohen të njëjtën ditë. Propozoi që në mbledhjen e radhës komisioni të ftoj kryetarin e FSSHK-së, për të parë se ku është procesi, sepse situata mundet të përsëritet prapë dhe ne si komision duhet të jemi të informuar për këtë.

Rita Hajzeraj – Tha se ajo ka propozuar në mbledhjen e kaluar që komisioni të vizitonte FSSHK-në, por disa nga anëtarët e komisionit reagojnë dhe thanë që ka përfunduar greva dhe është arritur një marrëveshje. Pavarësisht se komisioni ka një përbërje heterogjene, të gjithë i kanë përkrahur kërkesat e grevistëve. Nuk është serioze që për çështje të tilla komisioni të mos marrë një qëndrim.

Flora Brovina – Tha se komisioni duhet të jetë aktual, jo të diskutojë për një problem mbasi që problemi të përfundojë. Ne jemi përfaqësues të popullit para se të jemi partiak. Vërejtje për kryesinë e komisionit është që anëtarëve të komisionit t'ju lejohet që të debatojnë pa ngut.

Sadik Idriz – Tha se ndoshta komisioni nuk ka qenë aktual lidhur me vizitën e grevistëve. Sa i përket mbledhjeve të komisionit qëllimi është që komisioni të mos hyjë në një fazë ku nuk ka rend. Në mbledhjet e komisionit nuk ka ndodhur që një anëtarë i komisionit të kërkojë fjalën dhe mos të marrë atë. Por komisioni duhet të ketë një nivel të udhëheqjes.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz